



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” ADMINISTRATORI

Sektori i Prokurimeve, në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Shërbimeve, kërkon 1 (një) specialist, me kohë të reduktuar, si pjesë të Njesisë së prokurimit ose e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për objektin: “Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore dhe mjedise të jashtme”.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta, si më poshtë:

1. Të jetë diplomuar në nivelet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të, në fushën e: inxhinierisë së ndërtimit/hodroteknikës/gjeodezisë; brenda ose jashtë vendit. Diplomat e marra janë vendit, të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit;
2. Të jetë i pajisur me liçensë në fushën e tij;
3. Të jetë i aftë për punë;
4. Të ketë përvojë punë në fushën e kërkuar;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve **(17.10.2025 – 26.10.2025)** dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

1. Jetëshkrimin e tij/saj;
2. Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
3. Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
4. Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të kërkuara;
5. Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
7. Fotokopje e letërnjoftimit.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist tek prokurimet.*
Elbasan